



## **SYLLABUS I LËNDËS “ E DREJTA E DETYRIMEVE”**

| <b>Të dhëna bazike të lëndës</b> |   |
|----------------------------------|---|
| <b>Njësia akademike:</b>         | <b>Fakulteti Juridik</b>  |
| <b>Titulli i lëndës:</b>         | <b>E Drejta e Detyrimeve</b>  |
| <b>Programi:</b>                 | <b>Juridik i përgjithshëm</b>   |
| <b>Niveli:</b>                   | <b>Bachelor</b>   |
| <b>Statusi lëndës:</b>           | <b>Obligative</b>   |
| <b>Viti i studimeve:</b>         | <b>VI</b>   |
| <b>Numri i orëve në javë:</b>    | <b>3+2</b>  |
| <b>Vlera në kredi – ECTS:</b>    | <b>7</b>  |
| <b>Koha / lokacioni:</b>         | <b>Koha/lokacioni (termini i mbajtjes së ligjëratisë dhe salla), si dhe detaje të tjera do të caktohen në bashkëpunim me Fakultetin.</b>  |
| <b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>    | <b>Prof. Asoc. Dr. Muharrem Faiku</b>   |
| <b>Të dhënat kontaktuese:</b>    | <b>e-mail: muharem.faiku@uni-prizren.com</b>  |
| <b>Përshkrimi i lëndës:</b>      | <p>Lënda e drejta e detyrimeve zhvillon njohurinë e kandidatëve në fushën e Detyrimeve dhe parashtron pyetjet si përse premtimet janë zbatuar si kontrata, cilat premtime zbatohen, dhe se si ato zbatohen në marrëdhëniet e përditshme tregtare. Lënda vë theksin mbi analizën e ngushtë dhe kritike të detyrimeve të ligjit vendor si ajo ndikon në ditë për ditë të biznesit kontraktuese. Lënda shqyrton çështjet kryesore ligjore që prekin marrëveshjet e zbatueshme.</p> <p>Këto çështje përfshijnë pyetjet për atë se kur një kontratë të bëhet e detyrueshme, çfarë personash fitojnë të drejtat sipas një kontrate, kushtet nën të cilat kërkohet apo nuk kërkohet garancia për performancë, çka përbën shkelje të kontratës, dhe mjetet juridike në dispozicion në rast të shkeljes së kontratës. Do të ketë diskutime për problemet e mundshme në kontrata, dhe zgjedhjen e teknikave të kontratës për të shmangur rrezikun e procesit gjyqësor në mjedise të pasigurta ligjore, siç janë përdorimi i dëmeve të likuiduara dhe klauzola e dorëzimit. Gjatë tërë kohëzgjatjes së lëndës, do t'i kushtohet kujdes problemeve të përgjithshme të interpretimit të gjuhës së kontratës, rolit të kontratave në një shoqëri tregu, konflikt në mes të nevojës komerciale për siguri dhe kërkesave të drejtësisë individuale.</p> |
| <b>Qëllimi i lëndës:</b>         | <p>Qëllimi i këtij moduli është që studentëve të vitit të katër të Fakultetit Juridik t'u ofroj njohuri mbi të drejtën detyrimore. Kjo lëndë për studentët do të ofron njohuri shumë të rëndësishme në lidhje me objektin e detyrimeve, në lidhje me llojet e ndryshme të detyrimeve. Një theks të veçantë në këtë lëndë do të ketë edhe kontrata si burim i detyrimit, ku do të sqarohen kushtet, llojet, interpretimi dhe efektet juridike të kontratave si dhe mjetet kryesore të sigurimit të tyre. Gjithashtu do të trajtohen shkaktimi i dëmit, pasurimi pa</p>   |



|  |   |                  |                           |
|--|---|------------------|---------------------------|
|  | bazë, gjerimi i punëve të huaja pa porosi, ndërrimi i subjekteve në marrëdhëniet e detyrimit si dhe mënyrat e shuarjes së marrëdhënies së detyrimit.  |                  |                           |
| <b>Rezultatet e të nxënit:</b>   | <p>Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kuptojnë dhe sqarojnë konceptet dhe përmbajtjen e të Drejtës së detyrimeve, si e drejtë pozitive dhe e zbatueshme.</li> <li>- Të dijë t'i interpretoj dhe zbatoj dispozitat juridike nga fusha e të drejtës kontraktuese;</li> <li>- Të kuptoj ndikimin e shprehjeve dhe terminologjisë juridike të përdorura në hartimin e kontratave;</li> <li>- Të hartojnë dhe interpretojnë kontratat, gjegjësisht dispozitat kontraktuese;</li> <li>- Të dijë t'i interpretoj dhe zbatoj dispozitat juridike nga fushat dhe institutet tjera të së drejtës së detyrimeve, si shkaktimin dhe shpërblimin e dëmit, pasurimin e pabazë, gjerimin e punëve të huaja pa porosi dhe shprehjen e njëanshme të vullnetit;</li> <li>- Të përdorë metodat më adekuatë më qëllim të ndërtimit të një sistemi adekuat të të drejtës së detyrimeve;</li> </ul> |                  |                           |
| <b>Ngarkesa e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b> |   |                  |                           |
| <b>Aktiviteti</b>  | <b>Orë</b>  | <b>Ditë/javë</b> | <b>Gjithsej</b>           |
| Ligjërata  | 2   | 15               | 30                        |
| Ushtrime teorike/laboratorike  | 1   | 15               | 15                        |
| Punë praktike  |   |                  |                           |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet   | 10 min  | 15               | 1.5                       |
| Ushtrime në terren   |   |                  |                           |
| Kollokfiume, seminare  | 1   | 1                | 1                         |
| Detyra të shtëpisë   |   |                  |                           |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)                         | 4   | 15               | 60                        |
| Përgatitja përfundimtare për provim  | 5   | 5                | 25                        |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuis,provim final)  | 5   | 2                | 10                        |
| Projektet, prezantimet ,etj  |   |                  |                           |
| <b>Totali</b>  |   |                  | <b>142.5 orë (7 ECTS)</b> |
| <b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>  | E drejta e detyrimeve do të mësohet përmes ligjëratave, seminareve, shqyrtimi të rasteve, ushtrimeve, debateve duke mos i përjashtuar edhe format e tjera të mundshme. Ligjëratat paraqesin metodën e prezantimit   |                  |                           |

|  |   |
|--|---|
|  | <p>të rregullave themelore hyrëse dhe të përmbajtjes së lëndës e drejta e detyrimeve. Seminaret, do të jenë një proces interaktiv i mësimit për studentë, duke u bazuar në studimin e pavarur të materies nga ana e studentit nën mbikëqyrjen e mësimit të lëndës. Shqyrtimi i rasteve, gjatë mësimit do të jetë pjesë e të mësuarit, përmes të cilave studentët do të kenë mundësi studimin në mënyrë analitike, të problemeve nga fushën e të drejtës detyrime, duke përfshirë edhe analizimin e kontratave të ndryshme. Shqyrtimi dhe zgjidhja e rasteve do të bazohet në të drejtën pozitive në Kosovë, duke mos i përjashtuar edhe krahasimet me të drejtat tjera pozitive. Ushtrimet, janë pjesë e mësimit nga e drejta detyrime, përmes të cilave studentët do të mësojnë më shumë rreth zbatimit praktik të kontratave dhe llojeve të tjera të burimeve të detyrimeve. Shpesh herë do të ilustronet ora e mësimit edhe me paraqitjen e llojeve të ndryshme të kontratave dhe studenti mund të ngarkohet me hartimin e tyre.</p> |
| <p><b>Metodologjia e vlerësimit:</b></p> | <p>Vlerësimi intermediar i obliguar nga asistenti/ja vlerësohet me 20% (studenti duhet të arrijë 10% e kalueshmërisë së vlerësimit intermediar tek asistenti/ja, pasi që është kusht për të hyr tek provimi përfundimtar tek Profesori i lëndës).</p> <ul style="list-style-type: none"> <li><input type="checkbox"/> Detyrat ose angazhime tjera në ligjerata dhe ushtrime: 10%;</li> <li><input type="checkbox"/> Vijimi i rregullt: 10%;</li> <li><input type="checkbox"/> Provimi final: 60% (i obliguesh ë m për të gjithë studentët);</li> </ul>  |
| <p><b>Literatura</b></p>                 |   |
| <p><b>Literatura primare:</b></p>        | <ol style="list-style-type: none"> <li>1. E Drejta e Detyrimeve, Prof.dr. Nerxhivane Dauti, Prishtinë 2013;</li> <li>2. Komentar, Libri I dhe II, Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve, Prishtinë, 2013. 2013;</li> <li>3. E drejta e detyrimeve, Prof. Dr. Alejdin Alishani, Prishtinë 2006;</li> </ol>   |
| <p><b>Literatura shtesë:</b></p>         | <ol style="list-style-type: none"> <li>4. Andrija Gams, Hyrje në të drejtën civile, Prishtinë 2001.</li> <li>5. Gerard Legier, Edrejta civile Detyrimet, Përkthimin dhe botimin shqip: Tiranë 2009.</li> <li>6. Prof.Dr. Mariana Tutulani-Semini, Tiranë 2016.</li> </ol>   |

| <b>Plani i dizajnuar i mësimi:</b> |   |   |
|------------------------------------|---|---|
| <b>Java</b>                        | <b>Ligjërata</b>  | <b>Ushtrime</b>   |
| <i>Java e parë:</i>                | <ul style="list-style-type: none"> <li>-Nocioni, lënda, sistemi dhe rëndësia e së drejtës së detyrimeve.</li> <li>-Marrëdhëniet e të drejtës detyrimore me degë të tjera të së drejtës. Burimet e të drejtës së detyrimeve.</li> <li>-Nocioni, karakteristikat dhe klasifikimi i detyrimeve.</li> <li>-Vetitë detyrimeve të plotfuqishme.</li> <li>-Klasifikimi i detyrimeve.</li> <li>-Efektet e solidaritetit pasiv.</li> </ul> | Elaborim hyrës i lëndës e drejta e detyrimeve, bazuar në nocionin, lëndën, sistemin dhe rëndësinë e së drejtës së detyrimeve. |
| <i>Java e dytë:</i>                | <ul style="list-style-type: none"> <li>-Parimet e së drejtës së detyrimeve.</li> <li>-Kushtet e përgjithshme për lidhjen e kontratës.</li> <li>-Kushtet e veçanta për lidhjen e kontratës.</li> <li>- Lidhja e kontratës</li> <li>-Negociatat.</li> <li>-Ofertat.</li> </ul>  | Diskutim rreth parimeve të së drejtës së detyrimeve, kushtet e përgjithshme për lidhjen e kontratës, lidhja e kontratës.      |
| <i>Java e tretë:</i>               | <ul style="list-style-type: none"> <li>Klasifikimi i kontratave të detyrimit.</li> <li>-Interpretimi i kontratave.</li> <li>-Kontratat e ndaluara.</li> <li>-Kontratat me fajde.</li> </ul>   | Interpretimi i kontratave, dhe sqarim i kontratës së ndaluar dhe kontratës me fajde.  |
| <i>Java e katërt:</i>              | <ul style="list-style-type: none"> <li>-Mjetet e sigurimit personal të ekzekutimit të kontratave.</li> <li>-Dorëzania.</li> <li>-Pendimi.</li> <li>-Kushti penal.</li> <li>-Mjetet reale të sigurimit të ekzekutimit të kontratës.</li> <li>-Kapari.</li> <li>-Kaucioni.</li> <li>-Paradhënia</li> </ul>  | Analizim dhe sqarim i mjeteve të sigurimit të ekzekutimit të kontratës. Sqarim përmes rastit praktik.                         |
| <i>Java e pestë:</i>               | <ul style="list-style-type: none"> <li>-Efektet e kontratave ndërmjet palëve kontraktuese.</li> <li>-Efektet e kontratave në dobi të personave të tretë.</li> <li>-Kushtet, efektet juridike, natyra juridike e kontratës në dobi të personit të tretë.</li> <li>-Efektet e veçanta të kontratave me shpërblim.</li> <li>-Kundërshtimi për mospërbushjen e kontratës.</li> </ul>  | Trajtimi i efektit të kontratave ndërmjet palëve kontraktuese. Rast praktik.  |

|                        |   |   |
|------------------------|---|---|
|                        | <ul style="list-style-type: none"> <li>-Kundërshtimi për mospërbushje të pasigurt e kontratës.</li> <li>-Dëmtimi pamasë.</li> <li>-Përgjegjësia për mungesat materiale të sendit.</li> <li>-Përgjegjësia për mungesat juridike të sendit.</li> <li>-Garancioni për funksionim të mirë të sendeve.</li> <li>-Ndikimi i rrethanave të ndryshuara në ekzekutimin e kontratës.</li> </ul>   |   |
| <i>Java e gjashtë:</i> | <ul style="list-style-type: none"> <li>-Shuarja e kontratave.</li> <li>-Shuarja e kontratave me marrëveshje të palëve.</li> <li>-Shuarja e kontratës kur zhduket lënda e saj.</li> <li>-Shuarja e kontratës me vdekjen e palës kontraktuese.</li> <li>-Anulimi i kontratës.</li> <li>-Zgjidhja e kontratës për shkak të mosekzekutimit.</li> </ul>  | Rast praktik, përmes së cilit sqaruar shuajren e kontratës  |
| <i>Java e shtatë:</i>  | <ul style="list-style-type: none"> <li>-Shkaktimi i dëmit si burim i detyrimeve.</li> <li>-Kushtet e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar.</li> <li>-Aftësia deliktore.</li> <li>-Lidhja kauzale.</li> <li>-Veprimi i kundërligjshëm.</li> <li>-Faji.</li> <li>-Përgjashtimi i përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar.</li> <li>-Fuqia madhore.</li> <li>-Rasti.</li> <li>-Baza e përgjegjësisë deliktore civile.</li> <li>-Përgjegjësia subjektive.</li> <li>-Përgjegjësia objektive.</li> </ul> | Diskutime rreth shkaktimit të dëmit si burim i detyrimeve, duke përfshi: kushtet e përgjithshme për dëmin e shkaktuar, aftësin deliktore, lidhjen kaluzare, veprimin e kundërligjshëm dhe faji. |
| <i>Java e tetë:</i>    | <ul style="list-style-type: none"> <li>- Pasurimi pa bazë.</li> <li>-Nocioni i pasurimit pa bazë.</li> <li>-Kushtet e nevojshme për pasurimin pa bazë.</li> <li>-Rastet e pasurimit të pabazë.</li> <li>-Efektet e pasurimit të pabazë.</li> <li>-Natyra juridike e padisë së pasurimit të pabazë.</li> </ul>   | Diskutim i pasurimit pa bazë juridike, përmes rastit praktik.   |

|                             |   |   |
|-----------------------------|---|---|
|                             | <p>-Parashkrimi i kërkesës në pasurimin pabazë.</p> <p>-Gjerimi i punëve të huaja pa porosi.</p> <p>-Nocioni i gjerimit të punëve të huaja pa porosi.</p> <p>-Kushtet e gjerimit të punëve të huaja pa porosi.</p> <p>-Efektet juridike të gjerimit të punëve të huaja pa porosi.</p> <p>-Natyra juridike dhe llojet e gjerimit të punëve të huaja pa porosi.</p>   |   |
| <p><i>Java e nëntë:</i></p> | <p>Shprehja e njëanshme e vullnetit si burim i detyrimit.</p> <p>-Premtimi publik i shpërblimit.</p> <p>-Letrat me vlerë.</p> <p>-Letrat e legjitimacionit.</p> <p>Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</p> <p>Studentët janë të obliguar që t'i përmbahen kritereve të përcaktuara në syllabusin e lëndës dhe përgatitjen e provimit bazuar në literaturën bazë.</p> <p>Pjesëmarrja aktive / debati i studentëve në ligjëratë dhe në ushtrime do të vlerësohet.</p> <p>Studentët obligohen që t'i përmbahen politikave akademike dhe rregullave të mirësjelljes, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li><input type="checkbox"/> Vijimi i rregullt në ligjëratë dhe ushtrime;</li> <li><input type="checkbox"/> Respektimi i orarit në ligjëratë dhe ushtrime;</li> <li><input type="checkbox"/> Mos lëshimi i sallës gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve;</li> <li><input type="checkbox"/> Ruajtja e integritetit akademik;</li> <li><input type="checkbox"/> Ruajtja e disiplinës gjatë procesit mësimor;</li> <li><input type="checkbox"/> Mospërdorimi i telefonave celular gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve (përveç në raste urgjente);</li> <li><input type="checkbox"/> Respektimi i rregullave gjatë testeve dhe provimit (mos kopjimi, mos bisedimi me kolegë, etj.)</li> </ul> <p>-Shenjat e legjitimacionit.</p> | <p>Analizim i njësis mësimore shprehja e njëanshme e vullnetit si burim i detyrimeve.</p> |

|                              |  |   |
|------------------------------|--|---|
| <i>Java e dhjetë:</i>        | -Efektet e detyrimeve<br>-Vonesa e debitorit<br>-Vonesa e kreditorit<br>-E drejta e ndaljes<br>-Kundërshtimi i veprimeve juridike të debitorit (patria pauliana)   | Rast praktik përmes së cilit sqarohen efektet e detyrimeve.   |
| <i>Java e njëmbëdhjetë:</i>  | Ndërrimi i subjekteve në marrëdhëniet e detyrimit.<br>-Cedimi.<br>-Ndërrimi i debitorit.<br>-Dërgimi.  | Elaborim i ndërrimit të subjekteve në marrëdhënien e detyrimeve.  |
| <i>Java e dymbëdhjetë:</i>   | -Shuarja e marrëdhënieve të detyrimit sipas vullnetit të subjektit të detyrimeve.<br>-Shuarja e detyrimit me përmbushje.<br>-Shuarja e detyrimit me kompensim.<br>-Shuarja e detyrimit me faljen e borxhit.<br>-Shuarja e detyrimit me përtëritje.<br>-Shuarja e detyrimit të borxhit me skadim. | Rast praktik, shuarja e marrëdhënieve të detyrimeve sipas vullnetit të subjekteve të detyrimeve.                    |
| <i>Java e trembëdhjetë:</i>  | Mënyrat e shuarjes së detyrimit kundër vullnetit të subjektit<br>-Vdekja e subjektit<br>-Shuarja e detyrimit me urdhrin e ligjit<br>-Shuarja e detyrimeve me denoncim.<br>-Pamundësia e përmbushjes.<br>-Parashkrimi.  | Diskutim rreth mënyrës së shuarjes së detyrimeve.   |
| <i>Java e katërbëdhjetë:</i> | Analizimi i disa prej kontratave kryesore detyrimore, si kontrata e shitjes, dhurata, huapërdorja, huaja, qirasë etj.  | Analizimi i kontratave kryesore të detyrimeve siç janë kontrata e shitjes, dhurata, huapërdorja, huaja, qiraja etj. |
| <i>Java e pesëmbëdhjetë:</i> | Përsëritje   | Përsëritje  |

### Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Studentët janë të obliguar që t'i përmbahen kritereve të përcaktuara në syllabusin e lëndës dhe përgatitjen e provimit bazuar në literaturën bazë.

Pjesëmarrja aktive / debati i studentëve në ligjëratë dhe në ushtrime do të vlerësohet.

Studentët obligohen që t'i përmbahen politikave akademike dhe rregullave të mirësjelljes, si:

- Vijimi i rregullt në ligjëratë dhe ushtrime;
- Respektimi i orarit në ligjëratë dhe ushtrime;
- Mos lëshimi i sallës gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve;
- Ruajtja e integritetit akademik;
- Ruajtja e disiplinës gjatë procesit mësimor;
- Mospërdorimi i telefonave celular gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve (përveç në raste urgjente);
- Respektimi i rregullave gjatë testeve dhe provimit (mos kopjimi, mos bisedimi me kolegë, etj).

